



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VAU DEJES  
DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE  
MJEDISIT  
Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave

PROJEKT V E N D I M

Nr. 20, datë 02.06.2024

“Për dhënien në përdorim me afat deri në 9 (nëntë)vjet sipërfaqen pyjore prej 0.1732 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)” dhe 0.04 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do jepet në përdorim në ekonominë pyjore Koman Karme .

Mbështetur në nenin 9 pika 1.2 germa “a”, neni 18, nenit 27 pika 5, nenit 54 germa “e/l”, nenit 55 pika 3, neni 64 germa “c” të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; nenin 25 të ligjit nr. 57/2020, datë 30.04.2020 “Për pyjet”, pikën 49, shtojca 47, të VKM-së nr. 433 datë 08.06.2016, “Për transferimin në pronësi të bashkive pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive”, i ndryshuar; VKM-së nr. 748, datë 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës, distancës dhe gjerësisë së brigjeve të burimeve ujore”, shtojcën nr.1 pika 6/1 dhe 11/1 të VKM-së nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”; VKB-në Vau Dejës nr.7 dt. Mbi miratimin e listës së ngastrave/ nënngastrave pyjore të gatshme për dhënie në përdorim”; Udhëzimin nr. 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për Rregullat e procedurat e kërimit të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, ku në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.\_\_\_\_\_2024 të:

V E N D O S I

1. Miratimin e dhënies në përdorim të sipërfaqes prej 0.1732 ha “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike, kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj)” dhe 0.04 km rrugë për tu lidhur me sipërfaqen që do jepet në përdorim në ekonominë pyjore Koman Karme .

2. Afati i dhënies me qera të jetë deri në 9 (nëntë)vjet.

3. Vlera e dhënies me qira vjetore të jetë sipas VKM nr.559, datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për vëprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore”.

4.Për zbatimin e vendimit ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

**HARTOI PROJEKT-VENDIMIN  
DREJTORIA E PYJEVE, TURIZMIT DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

Konceptoi: Mark Suli, Specialist

Pranoi: Zeqir Ujka, Përgjegjes

Miratoi: Vehbi Shkjau, Drejtor

**KRYETARI  
KRISTIAN SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ZV/KRYETARI  
ALEKSANDRA GJONI**



**Sektori Ligjor Kontratave dhe Çështjeve Gjyqësore, Drejtoria Juridike e Prokurimeve dhe Integrimit:**

Konfirmoi bazën ligjore të projektvendimit- Ersilda Preka, Specialist

Pranoi bazën ligjore të projektvendimit Marinela Deda, Drejtor





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS**  
**DREJTORIA E MENAXHIMIT TË PYJEVE, INSPEKTIMIT DHE MBROJTJES SE**  
**MJEDISIT**

**Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave**

Nr. 22 prot.

Vau Dejës, më 02.06.2024

**RELACION**

**Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj”.**

**Drejtuar : Këshillit Bashkiak Vau i Dejës**

**Të nderuar këshilltarë,**

Administrimi i fondit pyjor dhe kullosor në territorin e Bashkisë Vau u Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: **Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:** Bashkitë janë përgjegjëse për kryerjen e këtyre funksioneve pika 5. *Administrimin e fondit pyjor dhe kullosor publik, sipas legjislacionit në fuqi.*

Ligji bazë mbi të cilin kryhet administrimi i fondit pyjor është ligji nr. 57/2020, date 30.4.2020 “Për pyjet”, neni 25, si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e(l) , neni 18 pika 2 , i ndryshuar është kompetencë e Këshillit të Bashkisë dhënia me qira të tretëve të pronave të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 “ Për rregullat ,procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik” pika 7.

***Siperfaqja e marrë në studim, pas miratimit në Këshillin Bashkiak do ti nështrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.***

**Siperfaqja që planifikohet të jepet në përdorim është 0.1732 ha dhe 0.04 km rruge per tu lidhur me siperfaqen qe do jepet ne perdorim.**

Në funksion të siperfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së **nr.559, datë 29.07.2022** “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor

kombëtar,për veprimtari ekonomike,si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”,shtojca 1,pika pika 6/1, dhe 11/1 si me poshtë.

6.Për qëllime pushimi,argëtimi,shendetsore,shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash,mjedise sportive,shplodhëse,kulturore, etj.”.				
Nr.	Përdorimi i territorit	Siperfaqia e përdorur në Ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/Ha/vit	
		1 vit	2- 5 vjet	6-10 vjet
1	Pyll Trungishte	198000	132825	110000
2	Pyll cungishte	138600	99000	82500
3	Pyll shkurre	138600	99000	82500
4	Kullota	138600	99000	82500
5	Tokë me Bimësi pyjore, djerr	99000	57200	49500
6	Inproduktive	99000	57200	49500

11. Për ndërtim/përdorim rruge për lidhjen e sipërfaqes së dhënë në përdorim, me rrjetin rrugor ekzistues		
Nr.	Përdorimi i territorit	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës për sipërfaqen e marrë në përdorim lek/km/vit
1	Pyll trungishte	70 000
2	Pyll cungishte	50 000
3	Pyll shkurre	35 000
4	Kullota	35 000
5	Tokë me bimësi pyjore, djerr	30 000
6	Inproduktive	25 000

Afati i dhenies me qira do të jetë deri në 9 (nëntë) vjet.

1. Vlera totalë e pagesës/vit sipas raportit teknik-ekonomik,do të jetë 21,852 leke në vit (Njezete e nje mije e teteqind e pesedhjete e dy leke).
2. Sipas VKM nr 748 date 01.12.2022 “Për përcaktimin e zonës ,distances dhe gjerësisë të brigjeve të burimeve ujore”,siperfaqja qe do jepet në përdorim ndodhet jashtë bregut të liqenit sipas pikës III.5:Në liqene,rezervuarë,pellgje me ujë,natyrorë apo artificialë,laguna,zona dhe gjersia e bregut është hapësira tokësore e krijuar nga vija ujore tek vija e krijuar nga gjurma e lënë nga uji në vite gjatë niveleve maksimale në të gjithë perimetrin e trupit ujqor.



Bazuar në sa më sipër, propozojmë miratimin e dhënies në përdorim me qera të sipërfaqes prej **0.1732 ha** për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj” dhe **0.04 km** rruge per tu lidhur me sipërfaqen qe do jepet ne perdorim.

**Bashkëlidhur po ju dërgojmë.**

**1.Dokumentacionin e plotë dhe hartën e ekonomisë.**

Duke ju falënderuar, ju ftojme në miratimin e projekt vendimit.

**Grupi i Punës**

**Ing.Mark Suli**

**Ing.Zeqir Ujka**

**Miratoi  
Drejtori  
Vehbi Shkjau**

## **Bashkia Vau Dejës Shtojca nr. 1**

### **RAPORT**

#### **MBI STUDIMIN TEKNIKO-EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM NGA FONDI PYJOR TË SIPËRFAQEVE NË PRONËSI PUBLIKETË BASHKISË VAU DEJËS “PËR QËLLIME PUSHIMI, ARGËTIMI, SHËNDETSORE, SHOQËRORE DHE PËR VËPRIMTARI TURISTIKE ,KAMPINGJE (KËNDE LOJRASH, MJEDISE SPORTIVE, SHPLODHËSE, KULTURORE, ETJ”.**

Bazuar në **Urdhërin nr. 36** datë 16/01/2024 të Kryetarit të Bashkisë për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore për dhënie të fondit pyjor me qira “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shlodhësë etj. Grupi i punës i përbërë nga z. Zeqir Ujka përgjegjësi sektorit të pyjeve z. Mark Suli, specialist i administrimit të pyjeve ,nga data **10/04/2024** deri në datën **11/04/2024** realizoj studimin tekniko-ekonomik ,verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqes pyjore me objekt dhënien në përdorim të sipërfaqes pyjore **0.1732 ha** “për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore etj” dhe **0.04 km** rrugë për tu lidhur me sipërfaqen e qe do jepet në përdorim.

Mbështetur në të dhënat e regjistrimit kadastral pyjor/kullësor sipas VKM nr.433, datë 08.06.2016, i ndryshuar “Për transferimin në pronësi të Bashkisë të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listës së inventareve, dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/Bashkisë, rezultojnë që sipërfaqja e propozuar për tu dhënë me qira është **0.1732 ha** dhe **0.04 km** rrugë në **ngastren nr.49/a** ,ekonomia pyjore **Koman Karme**, sipas listës së inventarit, **shtojca nr.47**, janë në pronësi/administrim të Bashkisë Vau Dejës. Përshkrimi i parcelave të sipërfaqes objekt studimi dhe kategoria e përdorimit të saj pasqyrohen në tabelat 1 dhe 2 të këtij raporti.

Ngaverifikimi në terren rezultojnë kjo gjendje: *(sipas tabelave përkatëse Bashkelidhur).*

Ndërhyrjet e propozuara do të jepen në përdorim për një afat **deri në 9 (nëntë) vjet** një sipërfaqe prej **0.1732** për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqërore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (këndeloirash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj” dhe **0.04 km** rrugë kalimi. Procedurat që ndiqen për dhënie në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullësor publik janë të mbështetura në ligjin nr 57/2020 “për pyjet”

Udhëzimin e Ministrisë së Mjedisit nr.1 datë 9.06.2016 “Përrregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullësor publik” pika nr 2 germa (a) dhe 7.



**Siperfaqja e marrë në studim, pas miratimit në Këshillin Bashkiak do të nënshtrohet procedurës së konkurimit publik sipas legjislacionit në fuqi.**

Pas miratimit të raportit tekniko- ekonomik dhe akteve të tjera normative si më sipër, kryetari Bashkise nxjerr urdherin për përgatitjen e dokumentave të ankandit nepermjet procedures së kunkurimit publik.

Tarifat e dhënies në përdorim nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-në nr.559, datë 29.07.2022“Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, shtojca 1, pika pika 6/1, 11/1 si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. **Shuma në lekë/vit konsistonnë:**

**1. Vlerën e përdorimit leke/ha/vit për qëllime pushimi, argëtimi, shëndetsore, shoqerore dhe për vëprimtari turistike ,kampingje (kënde lojrash, mjedise sportive, shplodhëse, kulturore, etj”**

a. Ngastra nr .49/a Tr. **0.1732 ha x 110 000 lekë/ha/vit = 19 052 lekë** në vit (Nentembedhjete mije e pesedhjete e dy ) lekë


**2. Vlerën e përdorimit lekë/hm/vit për rruge kalimi.**

b. Ngastra nr .49/a Tr. **0.04km rruge x 70 000 lekë/km/vit = 2800 lekë** në vit.

Në total **21,852 lekë** në vit (Njezete e një mije e teteqind e pesedhjetë e dy lekë.

#### **PËRPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO-EKONOMIK**

Ing. Zeqir Ujka



Ing. Mark Suli



**KRYETARI  
KRISTIAN SHKRELI**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR  
ZV/KRYETARI**

**ALEKSANDRA GJONI**





printo\_20240416\_0902

<https://geoportal.asig.gov.al>  
Data e Printimit: 16.04.2024

479222.738  
4660290.907



**Legjenda**

- Shtrese
- Baze
- Parcelat
- Ndertesat

479493.776  
4660290.907

**Kordinatat**


KRGJSH Karme

1	479350	4660241
2	479383	4660229
3	479370	4660186
4	479332	4660196
5	479373	4660196
6	479389	4660185
7	479397	4660166

479493.776  
4660118.707

479222.738  
4660118.707

<https://geoportal.asig.gov.al> ofron të dhëna  
gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike  
përgjegjëse  
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e  
autoritetit publik që i ka krijuar ato.



Sistemi koordinativ: KRGJSH  
Projektimi: KRGJSH